



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality

- Kuvendi Komunal
01 Nr.060/01-131993/3
Dt.28.06.2018
D r a g a s h

Në bazë të neneve 12.2. pika d, 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqversije Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28/2008) dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Dragashit, pas propozimit të kryetarit të Komunës Dragash, Kuvendi Komunal i Dragashit, nës eancën e dt.28.06.2018, miraton këtë:

V E N D I M
PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË VARRIMIT

I.

Miratohet Propozimi për lejimin e mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve të varrimit, për të gjitha rastet e vdekjeve në territorin e Komunës së Dragashit.

II.

Komuna e Dragashit për mbulimin e shpenzimeve të varrimit, të cekura në nenin I të këtij Vendimi, cakton shumën prej **100,00 (një qind) eurove**, për secilin rast, që, përveç Kërkesës, dëshmohet me çertifikatat e vdekjes, bashkësisë familjare dhe të Këshillit të Bashkësisë Islame.

III.

Ky Vendim zbatohet retroaktivisht, duke filluar nga dt.01.06.2018 dhe vlen deri në marrjen e ndonjë Vendimi tjetër që ka të bëjë me të njejtën çështje.

IV.

Shuma e përshkruar në nenin II të këtij Vendimi do të sigurohet nga buxheti i Komunës së Dragashit-pozicioni për mallëra e shërbime.

V.

Për zbatimin e këtij Vendimi përkudesen;: Kryetari i Komunës dhe Drejtorati për Ekonomi, Financa e Zhvillim.

VI.

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në protokolin e MAPL-së, si dhe 7 dita nga dita e publikimit në web-faqen e Komunës së Dragashit.

I dërgohet:

- Drejtoratit për Ekonomi, Financa e Zhvillim-Dragash,
- Kryetarit të Komunës-Dragash,
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (Zyrës Ligjore)-Prishtinë,
- Këshillit të Bashkësisë Islame-Dragash, dhe
- Arkivit



KRYESUESI I KUVENDIT
Betim Merdiu